



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Komuna e Drenasit  
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme  
Zyra e Prokurimit



KONTRATË PUNE  
KUSHTET E PËRGJITHSHME, TË VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

**TITULLI: LOT 7 RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT DRENICA DHE VERBICA** faza e parë  
(Pastrimi dhe Thellimi i Lumit.)

Numri identifikues: 611-19-0990-521 Datë: 15.08.2019 Nr. i arkivit: 400—47237

**NENI 1 PALËT NË MARRËVESHJE**

**KOMUNA E DRENASIT - DRENAS**, përfaqësuar nga **MENSUR GLLAREVA**, Zyrtar i Prokurimit ( më tutje "Punëdhënës")

NNP WENDA -VUSHTRRI përfaqësuar nga: **KADRI SELMANI** - Drejtor ( me tutje "Kontraktues")

**NENI 1: LËNDA**

Lënda e kontratës duhet të jetë kryerja e puneve nga Kontraktuesi në vijim: **LOT 7 RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT DRENICA DHE VERBICA** faza e parë (Pastrimi dhe Thellimi i Lumit.)

1.2 Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të Veçanta dhe të aneksit teknik [duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar].

1.3 Vendi i pranimit të punëve do të jetë: **LOT 7 RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT DRENICA DHE VERBICA** faza e parë (Pastrimi dhe Thellimi i Lumit.)

**NENI 2 KOHA E PËRFUNDIMIT**

2.1 Afati kohor për kryerje të punëve do të jetë: **Sipas Planit dinamik**. Operatori Ekonomik duhet të jetë në gjendje gadishmërie dhe sa herë që kërkohet duhet të angazhohet me inxhinier të natyrave përkatësse në mbikqyrjen e projekteve dhe në hartimin e projekteve dhe paramasave nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së punëve do të jetë: Komuna e Drenasit

2.3 Vendi i kryerjes së punëve do të jetë në adresën e treguar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.

**NENI 3 ÇMIMI**

**ÇMIMI I KONTRATËS; = 54,407.55€ (Pesëdhjetë e Katerëmijë e Katerëqindë Shtatë euro e 55 cent)**

**NENI 4 RADHITJA E DOKUMENTEVE TE KONTRATËS SIPAS PRIORITETIT**

Kontrata përbëhet nga dokumentet e mëposhtme, sipas prioritetit:

Marrëveshja e kontratës;  
Kushtet e Veçanta të Kontratës;  
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;  
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;  
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### NENI 5 KOMUNIKIMET

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlgimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlgim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhjet [Angleze] [Shqipe] [Serbe]<sup>1</sup> në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve

#### PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME

##### NENI 1 PËRKUFIZIMET

"Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

"Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtuesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

"Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grapi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

"Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

"Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

"Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

"Skicat" nënkuqtojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontaktuara.

"KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

"KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

<sup>1</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

## NENI 2 GJUHA DHE LIGJI I APLIKUESHËM

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## NENI 3 TRANSFERIMI

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojet kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:
  - kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
  - në rast të dhënes së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## NENI 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.
- 4.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Menaxheri i Projektit. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Menaxherit të Projektit. Menaxheri i Projektit do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.
- 4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.
- 4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjesë të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës
- 4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkizazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojet menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

## NENI 5 Personeli

- 5.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

## NENI 6 Obligimet e Kontraktuesit

- 6.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përbërështështë të kontratës, ai, duke iu eksposuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njostimi.
- 6.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.
- 6.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informata e marra lidhur me kontratën si private dhe

konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnje detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

6.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlgimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

6.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 8.

6.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përpunësje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvjetor që ka ndërmarr punë të ngjashme.

6.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur pë realizimin e punëve të kontraktuara.

6.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës përsyjet e mëposhtme:

në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe

në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

6.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës përsigurinë e të gjitha aktivitetave në vend punim.

#### **NENI 7 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit**

7.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materiale, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

7.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVKG për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

humbe ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;

humbe ose dëmtim i Pajisjeve;

humbe ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe dëmtim ose vdekje e personelit te tij.

7.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën përsigurim që ka përgjithësuar kompensimin e nevojshëm përsiguruar humbjen apo dëmet e pësuara.

7.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

7.5 Në qoftë se ekzistonjë arsyet e mjaftueshme dhe bindëse përzgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar përdorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose te eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërbllimit nga fitimi i kontra

#### **NENI 8 Programi**

8.1 Brenda kohës se specifikuari ne KVKG, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program pëmiratim. Programi do te përbaje se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet përdorëzim dhe miratim te vizatimeve, metodat e përgjithshme që do ti zbatoje, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuari.

8.2 Nëse menaxheri i projektit për me tepër kërkon modifikime ne programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'i ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuara në KVKG.

8.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

8.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëloj ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve

nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

#### **NENI 9 Inspektimi dhe testimi**

Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.

9.4 Koston e testimit si dhe çdo gjë tjeter ne lidhje me testimin do ti sigurojë kontraktuesi, në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

9.5 Në qoftë se Menaxheri i Projektit ose kontraktuesi nuk pajtohen me rezultatet e testimit, mund te caktojnë kohën dhe vendin për ri-testim. Koston e ri-testimit e siguron pala e cila ka gabuar në rezultatet e testimit. Në qoftë se pas testimit, Menaxheri i Projektit konstaton se cilësia e materialeve nuk është e cilësisë së materialeve të specifikuara, ka të drejtë të kërkojë nga kontraktuesi ndërrimin e materialit pa ndryshuar çmimin kontraktues.

#### **NENI 10 Fillimi i punëve**

10.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

10.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

#### **NENI 11**

##### **Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

11.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyet:

Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;

Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 30;

11.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèc nëse ka ndonjë marrëveshje tjeter ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

11.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit te detajeve sipas Nenit 11.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

#### **NENI 12**

##### **Paralajmërim i hershëm**

12.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

12.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

12.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tillë ose te përjashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

#### **NENI 13**

##### **Korrigjimi i defekteve**

13.1 Menaxheri i Projektit do tē njoftoj Kontraktuesin mbi ndonjë defekt para përfundimit të periudhës garantuese tē defekteve, e cila fillon në Përfundim. Kohëzgjatja e periudhës garantuese tē defekteve është përcaktuar në KVK. Periudhës garantuese e defekteve do te zgjatet deri sa te përmirësohen defektet.

13.2 Çdo here që epet njoftim mbi Defektet, Kontraktuesi do t'i korrigjoj defektet brenda afatit kohor tē specifikuar në njoftimin e Menaxherit tē Projektit.

13.3 Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do tē arrijë cilësinë e duhur tē punës brenda kohës së caktuar nga Menaxheri i Projektit dhe kjo do tē arrihet pa ndryshimin e çmimit tē konratës.

13.4 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për tē korriguar defektet e evidentuara nga Menaxheri i Projektit brenda afatit tē caktuar, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë defektet ose do tē angazhojë një person tē tretë për t'i eliminuar defektet.

13.5 Autoriteti Kontraktues do tē kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do tē kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar tē konratës.

#### **NENI 14 Paramasa dhe Parallogaria**

14.1 Paramasa dhe parallogaria duhet tē përbajnjë pajisje pér ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet tē kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret pér tē llogaritur çmimin e konratës. Kontraktuesi do tē paguhet pér sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë pér çdo artikull.

14.2 Në rast tē konratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet tē përbaj aktivitetet me çmim pér punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret pér monitorim dhe kontroll tē kryerjes së aktiviteteve në bazë tē tē cilave Kontraktuesi do tē paguhet. Nëse pagesa pér Materiale në vend punim do tē bëhet veç e veç, Kontraktuesi do tē tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

#### **NENI 15 Vërtetimet e pagesës**

15.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit tē projektit raportet mujore tē çmimeve tē vlerësuara tē punëve tē përfunduara me minus shumën kumulative tē vërtetuar më parë.

15.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer tē kontraktuesit pér tē vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

Vlera e punës së kryer do tē përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

Vlera e punës së përfunduar përfshin:

Në rastin e Konratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlera e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose

Në rast tē konratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do tē përbëj vlerën e aktiviteteve tē përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve pér kompensim.

#### **NENI 16 Pagesa**

16.1 Pagesat do tē bëhen në Euro.

16.2 Pagesat do tē rregullohen pér zbritje pér pagesat paradhënie dhe tē mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet tē paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes pér pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do tē llogaritet nga data në tē cilën pagesa duhet tē ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase pér kredi në sektorin e ndërtimit.

16.3 Artikujt e Punëve pér tē cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do tē paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do tē konsiderohen tē mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Konratë.

16.4 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

#### **NENI 17** **Shkaqet për kompensim**

17.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK. Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.

Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.

Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.

Parapagimi vonohet.

Menaxheri i Projektit pa arsyen të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përm bushje të kontratës. Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

17.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

#### **NENI 18 Tatimi**

18.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

18.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

18.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

18.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

#### **NENI 19** **Dëmet e likuiduara**

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zgres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

#### **NENI 20** **Parapagimi**

20.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë dhe nga një bankë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

20.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

20.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

**NENI 21**  
**Mbajtja e Parasë**

21.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalohet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do te tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale.

21.2 Me lëshimin e Certifikatës mbi Përfundimin e Punëve nga ana e Menaxherit të Projektit, shuma totale e ndaluar do t'i paguhet Kontraktuesit kur të kaloj periudha garantuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Kontraktuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korriguar. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garacion bankar "me kërkesë".

**NENI 22**  
**Siguria e ekzekutimit**

22.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

22.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

22.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

**NENI 23**  
**Kostoja e Riparimeve**

23.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

**NENI 24**  
**Përfundimet dhe Certifikata e pranimit te punëve**

24.1 Pasi qe kryesisht te jene përfunduar te gjitha punët dhe te kenë kaluar te gjitha Testet e kompletimit te punëve te përshkruara ne kontrate, kontraktuesi mund te njoftoj Menaxherin e Projektit me një njoftim me shkrim se do ti kryej te gjitha punët e diskutueshme gjate Periudhës Garantuese te defekteve. Ky njoftim dhe ky zotim se te gjitha punët e diskutueshme do te kompletohen gjate Periudhës garantuese për defekte do te merren si kërkese e Kontraktuesit për Menaxherin e Projektit për lëshim te Certifikatës-mbi-Pranim te punëve.

24.2 Brenda 21 ditëve te pranimit te kësaj kërkese Menaxheri i Projektit ose do te lëshoj Certifikatën e pranimit te punëve, duke cekur datën, sipas mendimit te tij, e përfundimit te punëve ose do te jap instruksione për punët te cilat duhet te kryhen nga ana e Kontraktuesit para lëshimit te kësaj Certifikate.

24.3 Kontraktuesi, me pëlqimin e Menaxherit te Projektit, ka te drejtën e pranimit te kësaj Certifikate brenda 21 ditëve te kompletimit te punëve dhe te përmirësimit te defekteve te cekura.

24.4 Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër vend punimin dhe punët brenda shtatë ditëve nga lëshimi i certifikatës së përfundimit nga Menaxheri i Projektit.

**NENI 25**  
**Llogaritja përfundimtare**

25.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit te Projektit llogarinë e cila përfshin në detaje të gjitha punët te cilat duhen ti paguhet Kontraktuesit sipas kontratës para përfundimit të Periudhës garantuese për defekte. Menaxheri i projektit do te lëshoj Certifikatën e periudhës garantuese te defekteve dhe do te certifikoj cilëndo pagese finale e cila duhet ti paguhet Kontraktuesit brenda 15 ditëve pas pranimit te llogarisë nga ana e kontraktuesit nëse nuk vëren te meta. Nëse llogaritja përfundimtare e kontraktuesit nuk është e plotë apo është e pa saktë, Menaxheri i Projektit brenda 15 ditësh do të paraqesë një plan që paraqet fushëveprimin e korrigjimeve dhe shtesave që janë të nevojshme. Nëse llogaria përfundimtare edhe pas ri-dorëzimit akoma mbetet e pakënaqshme, Menaxheri i Projektit do te vendos mbi shumën e cila do ti paguhet Kontraktuesit dhe do te lëshoj certifikatën mbi pagesën.

**NENI 26**  
**Shkëputja e kontratës**

26.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

26.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

Kontraktuesi ndërprenë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;

Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsyё të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;

Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;

Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;

Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

26.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 26.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

26.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijojen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë.

Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marries së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

26.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

**NENI 27**  
**Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

27.1 Nëse kontrata ndërpitet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

27.2 Nëse kontrata ndërpitet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit përmbytjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

**NENI 28 Prona**

28.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpitet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

**NENI 29**  
**Lirim i Ekzekutimi**

29.1 Në qoftë se pamundësitet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend

punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

### NENI 30 Forca madhore

30.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitet etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

30.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcen Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me konratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përcakton Forcen Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të konratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me konratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e konratës.

### NENI 31

#### Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundojen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkесës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkесës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### NENI 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

ose vendim nga gjyqi;

kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

32.2 Para nënshkrimit te konratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**PJESA III E KONTRATES      KUSHTET E VEÇANTA**

- KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	Të përgjithshmet
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
Gjuha e përdorur	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <u>Gjuha e procedurës - shqipel.</u>
Përgjegjësi a dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianeve dhe Materialeve: (sipas ligjeve ne fuqi) humbe ose dëmtim i Pajisjeve deri në shumën e kontratës; humbe ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianeve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën deri në shumën e kontratës; dëmtim personal ose vdekje:  të punëtorëve të Kontraktuesit: sipas ligjeve në fuqi. (ii) të personave të tjera: sipas ligjeve në fuqi.
Programi	8.1	Menaxherët e Kontraktuesit dhe Autoritetit kontraktues duhet ta hartojnë Planin e Menaxhimit të kontratës konform Nenit 81 të Ligjit Ligjt Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjt Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvjoje në profesion dhe mundësishët nga Njësia kërkuese dhe komisionin për pranim teknik me një Vendim tjetër. Të dy palët obligohen të mbajnë ditarin e punës dhe nga një kopje të dorëzohen në arkivin e dosjes për pagesë.
Programi i azhruar dhe pagesat	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar sipas planit dinamik. Pagesat kryhen ashtu si raporton Organi mbikqyrës, pagesa e fundit kryhet vetëm pasi të ofrohet Garancioni për eliminimin e të metave në shumën prej 10 % të vlerës së ofertës.

Inspektimi dhe testimi	9.1	Inspektimin dhe testimin e materialeve e kryen Menaxheri sa herë që kjo shihet e nevojshme. Shpenzimet për testetimet e para i kryhen Punëkryrësi, ndërsa herave tjera (kur Menaxheri nuk është i kënaqur) kryhen nga Autoriteti Kontraktues.
Fillimi i punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës. Punëkryerësi duhet ta ketë në vendpunishte çdo herë Inxhinierin e prezantuar në dosje të tenderit SHEFI VESELI) inxh. i ndërtimtarisë- Drejtimi i konstruktiv). Nëse pas urdhërit prej tre ditëve nuk paraqitet Ixhinieri i OE në vend punishte, Komuna ka te drejtë t'i jap urdhresen e fundit per nderprerje te kontratës. Poashtu njëjtë vepron edhe kur nuk i angazhon paisjet me te domosdoshme ne vendpunishte. Inxhinieri duhet të nënshkruhet çdo herë në situacionet e hartuara nga OE fitues dhe në fletët e ditarit të punës. Ndërrimi evnetual i inxhinierit të paraqitur në dosje bëhet vetëm me një arsyetim bindës, me Pëlqim të Menaxherit komunal.
Nënkontraktimi	10.2	O E i lejohet nënkontraktimi deri në 10% të vlerës së kontratës, mbi këtë përqindje dhe deri në 40 % të shumës së kontratës vetëm me aprosimin e Menaxherit dhe Organit mbikqyrës të caktuar nga komuna.
Mbarimi i punimeve	10.3	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Planit dinamik dhe Planit te menaxhimit të kontratës të nënshkruar nga të dy palët.
Përmirësimi I defekteve	13.1	Periudha garantuese e defekteve është 2 vite.
Shkaqet përkompensi m	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë sipas kërkesave dhe paraqitjes së rasteve nga Drejtoria për INFRASTRUKTURE PUBLIKE
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës. Me propozimin e Menaxherit të Projektit dhe aprosimin e Autorizuesit Operatori Ekonomik futet në penale nëse ka tejkalim të ditëve. Nëse ka tejkalim të ditëve dhe Operatori Ekonomik nuk është fut në penale atëherë Menaxheri duhet të jap një arsyetim përmos futje në penale.
Monitorimi	19.2	Menaxheri i projektit obligohet që monitorimin e kontratës në aspektin Ligor herë pas here ta kryej konform neneve të kontratës dhe ligjeve në fuqi dhe duhet të bindet se kontrata implementohet ashtu edhe si është hartuar. Në rast të kërkesës për nderprerje të punimeve apo kontratës, Menaxheri i Projektit duhet ta njoftoj ZP duke ia bashkangjite te gjitha shkresat, komunikimet, dhe të bindet se janë shterre te gjitha mundesitë konform neneve të kushteve të kontratës. Poshtu merrë përsipër së bashku me Avokatin komunal të përballet edhe me pengesat eventuale dhe mbrojtjen e kontratës dhe interesave të Komunës para institucioneve tjera.
Parapagimi	20.1	Shuma e parapagimit (avans) : 0
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: 0 %
Siguria e ekzekutimi	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10 % e shumës së ofertës, validiteti i sigurimit sipas Planit dinamik, plus 30 ditë tjera.

t		
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha punët e kryera dhe të papaguara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëv eshjeve	31.2	Mundësisht në mes të dy palëve.
Zgjidhja e mosmarrëv eshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [jykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë.
Mbikëqyrja	33.1	Menaxher apo Mbikqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marë pjesë në hartimin e paramasave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave. Menaxheri i projektit duhet të veproj konform Udhëzimit A01, përkatësisht Nenit 61.
Punët shtesë	33.2	Do të ecet me procedurë për punë shtesë nëse paraprakisht merret autorizimi nga Mbikqyrësi dhe ZKA-ja.
Pagesat	33.3	Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për punët e kryera do të caktohet nga Menaxheri i Projektit.
Dorëzimi i dokumentave	33.4	Zyrtari ndërlidhës apo Menaxheri para se ta dërgoj dokumentacionin për pagesë në Thesar duhet të binden se ju kanë ofruar të gjitha dokumentet si: Plani i menaxhimit të kontratës, aktvendimet, procesverbalet, raportet, situacionet për punët e kryera të nënshkruara nga inxhinierët, faturat, atestet për materialet e përdorura, shkresat, fletët e ditarit të punës të nënshkruara nga inxhinierët, arsyetimin për tejkalinin e ditëve kalendrike, sigurimet, etj, në të kundërten e merrë përgjegjësinë.
Arkimi i dokumentave	33.4	Zyrtari ndërlidhës dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkua nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë. Një kopje e faturës, raportit të pranimit pas përfundimit të projektit duhet të dorëzohen në ZP.
Hyrja në fuqi	33.5	Kontrata hynë në fuqi 3 ditë pas nënshkrimit të palëve ose si ditë zyrtare do te konsiderohet dita kur Menaxheri jep urdher per fillimin e punimeve. Kontrata hartohej në 3 kopje originale. Vendimi mbi caktimin e Menaxherit dhe Plani i menaxhimit duhet të hartohej menjëherë pas nënshkrimit të kontratës por asesi pas fillimit të punimeve.

Kësaj kontrate i bashkangjitet: Oferta financiare e Tenderuesit (Paramasa dhe paralogaria e çmimeve).

Për Autoritetin Kontraktues	Për Kontraktuesin		
Për Autoritetin Kontraktues	Për Kontraktuesin		
Emri:	MENSUR GLLAREVA	EMRI:	KADRI SELMANI
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.08.2019	Data:	19/08/19
Vula:		Vula:	

## FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

### Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 611-19-4364-5-2-1

**Titulli i kontratës: RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT DRENICA DHE VERBICA faza e pare (pastrimi dhe thellimi i lumbit) LOT 5 , LOT 6 ,LOT 7.**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftësës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim;

**3. LOT 7 PASTRIMI DHE HAPJA E LUMIT DRENICA VUKOC ,POTERRK, ARLLAT NEGROC DHE NGA PJESA E SHTRUBULLOVES, KORROTICE E ULET DERI NE PJESEN E KORROTICES SE EPERME L=9219.00 m' B=10.0m'**

3. Çmimi total i tenderit është:

**54.407,55 EUR**

Dhe në fjalë [*shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro*]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 60 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [*shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet*] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [*shëno emrin e udhëheqësit*]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK